

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr.9128, datë 29.7.2003

**PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË FINANCIAR
TË PILOTËVE FLUTURUES NË PENSION**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë një trajtim financiar të pilotëve, që kanë fluturuar me avionë reaktivë e me avionë me helikë, në shtesë të pensionit të pleqërisë, të cilin e përfitojnë nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm, në momentin e lindjes së të drejtës së përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 2

Baza e llogaritjes

Paga referuese është bazë për llogaritjen e këtij trajtimi financiar të veçantë. Me pagë referuese, për efekt të këtij ligji, kuptohet paga bazë për funksionin, plus shpërblimin për gradën, të njësuar me pagën referuese të funksionit organik të ushtarakut aktiv në të njëjtën detyrë me përfituesin, në momentin e lindjes së të drejtës për trajtim financiar të veçantë.

Neni 3

Financimi dhe llogaritja e përfitimit

Efektet financiare që rrjedhin nga ky ligj përballohen nga Buxheti i Shtetit. Pagimi dhe caktimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Mënyra e llogaritjes së përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Kushtet e përfitimit

Pilotët, të cilët kanë fluturuar me avionë reaktivë e avionë me helikë dhe që kanë plotësuar ose plotësojnë kushtet për pension pleqërie, përfitojnë, përveç pensionit të pleqërisë, një trajtim të veçantë financiar në shtesë të pensionit në masën:

1. 50 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:

a) kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë jo më pak se 12,5 vjet kalendarikë;

b) kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë jo më pak se 16,5 vjet kalendarikë.

2. 35 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:

a) kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë jo më pak se 8,5 vjet kalendarikë;

b) kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë jo më pak se 12,5 vjet kalendarikë.

3. 25 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie, për funksionet aviondrejtues fluturues, qitës-radist, radist, teknik, fluturues bordi, me jo më pak se 15 vjet vjetërsi në shërbim, pavarësisht nga koha e daljes në pension.

Neni 5

Shuma e pensionit

Shuma e pensionit të plotë të pleqërisë plus masën e trajtimit të veçantë financiar, sipas këtij ligji, nuk mund të jetë më e madhe se 50 për qind e pagës referuese të pilotit fluturues, kur ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie.

Masa e trajtimit të veçantë të pilotëve fluturues indeksohet sa herë që indeksohen pensionet e pleqërisë.

Neni 6

Njësimi i funksioneve

Kur funksionet organike, në çastin kur piloti fluturues ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Forcave të Armatosura, Ministri i Mbrojtjes bën njësimin e tyre, për efekt të pagës referuese, me funksionet organike që ekzistojnë në Forcat e Armatosura, në çastin kur pilotit i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 7

Dispozita kalimtare

Pilotëve fluturues, që u lind e drejta për përfitimin e trajtimit të veçantë, sipas këtij ligji dhe përfitojnë njëkohësisht nga neni 12 i ligjit nr.8087, datë 1.3.1996 "Për sigurimin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet trajtimit të veçantë dhe pensionit suplementar të pleqërisë.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi